


FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO



# MUNDËSI E RE INVESTIMI NË EURO

Krenarë që investojmë në Shqipëri

- Menaxhim profesional i aseteve tuaja
- Shuma minimale e investimit është 250 Euro
- Të ardhura të kënaqshme nga investimi
- Asnjë kufizim për t'u tërhequr nga Fondi



**Raiffeisen**  
**INVEST**

[www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) | telefon: 04 2 381 381

KORRIK 2019

# PROSPEKT

Ky Prospekt përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që investitorët potencialë të jenë në gjendje të bëjnë vlerësimet e duhura mbi objektivat dhe strategjitë kryesore të fondit të investimit Raiffeisen Invest Euro (në vijim: Fondi), mbi rreziqet e investimit në të, profilin e investitorit të përshtatshëm, si dhe mbi tarifat e Fondit.

Shoqëria e administrimit Raiffeisen Invest sh.a konfirmon që ky Prospekt përmban të gjithë informacionin e konsideruar thelbësor në kontekstin e objektivit të investimit dhe deklaron që ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm që informacioni që përmban ky Prospekt, të jetë në përputhje me faktet, dhe që nuk ka përjashtime faktesh që mund të ndikojnë mbi domethënien e tij.

Informacioni i dhënë në këtë Prospekt është shprehur ndershmërisht, për të orientuar investitorët. Çdo opinion, parashikim i përmendur nuk ka për qëllim keqinformimin e investitorit. Janë kryer të gjitha kërkimet e duhura për të konstatuar dhe verikuar për sa më sipër.

Për çdo investitor është e këshillueshme ta lexojë këtë prospekt përpara marrjes së vendimit për blerjen e kuotave në Fond, në mënyrë që të krijojë një ide të qartë për karakteristikat e Fondit dhe rreziqet e investimit në të.

# TABELA E LËNDËS

	PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORE	4
1	INFORMACION MBI FONDIN	5
1.1	FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO, SIPËRMARRJE INVESTIMESH KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE	5
1.2	TË DHËNAT PËR FONDIN	5
1.3	POLITIKA E INVESTIMEVE	6
1.3.1	PROFILI I INVESTITORIT	6
1.3.2	INVESTIMET E LEJUARA	6
1.3.3	OBJEKTIVAT E INVESTIMIT DHE STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT	7
1.3.3.1	OBJEKTIVI I INVESTIMIT	7
1.3.3.2	STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT	7
1.4	RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND	8
1.4.1	RREZIKU I TREGUT	9
1.4.2	RREZIKU I KURSEVE TË KËMBIMIT	9
1.4.3	RREZIKU I KREDISË	9
1.4.4	RREZIKU I LIKUIDITETIT	9
1.4.5	RREZIKU I SHLYERJEVE NË SHUMA TË MËDHA	10
1.4.6	RREZIKU RREGULLATOR	10
1.4.7	RREZIKU I MOS-DIVERSIFIKIMIT	10
1.4.8	RREZIKU I PALËS TJETËR	10
1.4.9	RREZIKU I PERFORMANCËS	10
1.4.10	RREZIKU I INFLACIONIT	10
1.4.11	RREZIKU I PEZULLIMIT TË SHLYERJES SË KUOTAVE	10
1.4.12	RREZIKU I PERSONELIT KYC	11
1.4.13	RREZIKU OPERACIONAL	11
1.4.14	RREZIKU I VLERËSIMIT TË ASETVE	11
1.5	SHUMA MINIMALE E INVESTIMIT DHE VLERA FILLESTARE E KUOTËS	11
1.6	TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT	11
1.7	MËNYRA DHE KUSHTET E BLERJES APO SHLYERJES SË KUOTAVE	12
1.7.1	BLERJA E KUOTAVE NË FOND	12
1.7.2	SHLYERJA E KUOTAVE	12
1.8	KËMBIMI I KUOTAVE	13
1.9	PEZULLIMI I SHLYERJES SË KUOTAVE TË FONDIT	13
1.10	ADMINISTRIMI I PJESËS SË FITIMIT PËR MBAJTËSIT E KUOTAVE	14
1.11	METODA DHE FREKUENCA E VLERËSIMIT TË ASETVE TË FONDIT DHE ÇMIMIT PËR KUOTË	14
1.12	INFORMIMI I INVESTITORËVE	15
1.13	MBYLLJA E FONDIT	15
1.13.1	RRETHANAT E MBYLLJES	15
1.13.2	KUSH E KRYEN PROCESIN E MBYLLJES	15
1.13.3	LIKUIDUESI, PROÇEDURAT DHE AFATI KOHOR PËR MBYLLJEN E FONDIT	15
1.14	TARIFAT	16
1.15	SHPENZIME TË TJERA	16
1.16	TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE MBAJTËSIT TË KUOTAVE	17
1.17	VITI FINANCIAR	17
1.18	AUDITUESI	17
2	INFORMACION MBI DEPOZITARIN	18
3	INFORMACION MBI SHOQËRINË ADMINISTRUESE	19
3.1	FORMA LIGJORE	19
3.2	FONDET NËN ADMINISTRIM	19
3.3	ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUES	19
3.3.1	ASAMBLEJA E AKSIONARËVE	19
3.3.2	KËSHILLI I ADMINISTRIMIT	19
3.3.3	ADMINISTRATORËT	21
4	INFORMACION PLOTËSUES	21
4.1	ETIKA DHE KONFLIKTI I INTERESIT	21
4.2	KUJDESI	21
4.3	STATUSI "FATCA"	22
4.4	ANKESAT	22

# PËRKUFIZIME TË TERMAVE KRYESORE

Në këtë prospekt, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

**AMF:** Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

**Asete:** titujt, instrumentet e tregut të parasë, instrumentet derivative, para dhe pasuri të tjera, në pronësi të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

**Depozitar:** një bankë e nivelit të dytë e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbime të kujdestarisë, depozitimit dhe besimit dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për sipërmarrjet e investimeve kolektive;

**Diversifikim i portofolit:** investim i aseteve të Fondit në instrumente të llojeve të ndryshme, me qëllim zvogëlimin e rreziqeve të lidhura me investimin;

**Duration:** Tregues i ndjeshmërisë së çmimit të një instrumenti me të ardhura fikse ndaj luhatshmërisë së normave të interesit. Duration përcakton ndryshimin e vlerës së një portofoli investimesh kur normat e interesit luhaten me 1%. Zakonisht shprehet në numër vitesh;

**FATCA:** ligj federal i SHBA, i cili u kërkon të gjithë institucioneve financiare të huaja t'i raportojnë Agjencisë së të Ardhurave në SHBA (IRS) informacionin mbi llogaritë financiare të taksapaguesve amerikanë, ose të entiteteve të huaja në të cilat taksapaguesit amerikanë zotërojnë një përqindje të rëndësishme;

**Fond investimi:** sipërmarrja me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate nëpërmjet ofertës publike të kuotave;

**Investitor:** subjekti që ka në pronësi kuota në një fond investimi;

**Këshilli i administrimit:** sipas ligjit për shoqëritë tregëtare është i vetmi organ i shoqërisë administruese që ka kompetenca manaxhuese dhe mbikëqyrjeje (sistemi i drejtimit me një nivel);

**Kuota:** të drejtat e investitorit në Fondin e investimit;

**Kuota akumulimi:** kuotat e një fondi, për të cilat të ardhurat nga investimi rinvestohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave;

**Kthim nga investimi:** Tregues i performancës së një fondi, i cili përcakton nëse investimi i aseteve të Fondit ka qenë efikas ose jo;

**Marrëveshje e riblerjes:** marrëveshje sipas të cilës blerësi angazhohet që të shesë një letër me vlerë tek shitësi, me një çmim dhe në një datë të rënë dakord paraprakisht;

**Menaxher i Investimeve:** personi përgjegjës në shoqërinë administruese për administrimin e portofolit të investimeve;

**Ofertë publike:** ftesa për të blere kuota në fondin e investimit, e cila i drejtohet një numri të papërcaktuar personash, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv.

**Portofol:** tërësia e aseteve financiare të Fondit;

**Prospekt:** dokumenti i bërë publik, që përmban informacionin më të rëndësishëm për sipërmarrjen e investimeve kolektive, si objektivat e investimit, rreziqet, tarifatat etj;

**Raiffeisen INVEST:** Shoqëri administruese e fondit Raiffeisen Invest Euro;

**Rating (vlerësim) i letrave me vlerë** - renditje e letrave me vlerë, e kryer nga agjensitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të riskut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi. Letrat me vlerë të klasifikuara A, A2 dhe A3 përfaqësojnë risk relativisht më të ulët e për rrjedhim pritshmëria për kthimin nga investimi është më e ulët. Letrat me vlerë të klasifikuara B, BB dhe BBB përfaqësojnë risk mesatar, ndërsa letrat me vlerë të

klasifikuara C konsiderohen me risk të lartë e për rrjedhim kanë kthimin më të lartë të pritshëm nga investimi;

**Rregullat e fondit:** dokumenti kryesor që rregullon marrëdhënien ligjore mes shoqërisë administruese dhe investitorit në një fond investimi;

**Sipërmarrje investimesh kolektive (SIK):** personi juridik ose bashkimi i posaçëm i aseteve të investitorëve, që funksionon në formën e shoqërisë së investimit ose të fondit të investimit;

**Shoqëri administruese:** shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe e liçensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për themelimin dhe/ose administrimin e fondeve të pensionit dhe/ose fondeve të investimit;

**Shuma minimale e mbetur në fond:** vlera kufi e llogarisë në fond, nën të cilën llogaria mund të mbyllet;

**Treg i rregulluar:** çdo bursë, treg mbi banak ose çdo treg tjetër i organizuar i titujve, që vepron rregullisht, është i hapur për publikun dhe është i njohur zyrtarisht nga AMF-ja.

**Tituj ose Letra me vlerë** - tituj ose instrumente financiare të negociueshëm që i japin mbajtësit të tyre të drejta dhe detyrime dhe që tregëtohen për sigurimin e fitimit. Mund të jenë tituj të pjesëmarrjes në kapital ose tituj borxhi.

## 1 INFORMACION MBI FONDIN

### 1.1 FONDI RAIFFEISEN INVEST EURO, SIPËRMARRJE INVESTIMESH KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE

Fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh i paregjistruar si person juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënie kontraktuale, pas liçensimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim: AMF) dhe i administruar nga një shoqëri administruese. Kjo e fundit ka si veprimtari grumbullimin e aseteve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, asetet e të cilit investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve në përputhje me ligjin nr.10198 "Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive", datë 10.12.2009, dhe mbajtësit e kuotave të të cilit kanë të drejtën, jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e Fondit, por gjithashtu të kërkojnë në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre. Në këtë mënyrë, kuotat anulohen.

Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt. Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond. Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro është një sipërmarrje investimesh kolektive (SIK) me ofertë publike, i themeluar nga Raiffeisen Invest sh.a, shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe SIK, e cila grumbullon asetet monetare ose të ngjashme nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, dhe i administron ato me ndershmëri dhe profesionalizëm, në interesin më të mirë të investitorëve dhe të integritetit të tregut. Fondi Raiffeisen Invest Euro nuk mbështetet apo garantohet në çfarëdo lloj forme nga Banka Raiffeisen, nuk është produkt bankar dhe rreziku i investimit në të i përket tërësisht investitorit. **Investimi në fond nuk është një depozitë bankare dhe nuk është i siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.**

### 1.2 TË DHËNAT PËR FONDIN


Fondi u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 135, datë 26 Shtator 2012.

Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij më 17 tetor 2012.

Të dhënat e kthimit nga investimi dhe te riskut në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin dhe riskun në të ardhmen.

## TË DHËNA HISTORIKE

### Performanca vjetore e shkuar e Fondit



Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi. Kthimi vjetor i përket datës 31 Dhjetor të çdo viti.

### Tregues të Rrezikut ( në datë 31 Dhjetor 2018)

Kohëzgjatja mesatare e portofolit të investimit (Duration) është 3.06, ndërsa kohëzgjatja mesatare e modifikuar e portofolit të investimit (Modified Duration) është 3.00 në 31 Dhjetor 2018.

Devijimi standard është 1.77% në 31 Dhjetor 2018

Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit është në nivelin 2.

Treguesi i rrezikut sintetik dhe përfitimit jep informacion mbi nivelin e rrezikut të fondit (nga niveli 1 deri në nivelin 7) duke u bazuar mbi luhatshmërinë historike të performancës së fondit.

## 1.3 POLITIKA E INVESTIMEVE

### 1.3.1 Profili i investitorit

Fondi i drejtohet të gjithë personave fizikë apo juridikë, të cilët i konsiderojnë të përshtatshme objektivat e investimit të Fondit, synojnë një Fond likuid në çdo kohë dhe janë të përgatitur të marrin përsipër një shkallë të caktuar rrisht, kundrejt kthimeve të kënaqshme nga investimi.

Objektivat kryesore të Fondit sipas rradhës së prioriteteve janë siguria, likuiditeti dhe yield-i. Investitorët duhet të jenë në gjendje të pranojnë se të ardhurat dhe vlera e kapitalit të investuar mund të pësojnë luhatje si pasojë e natyrës potencialisht të paqëndrueshme të aseteve të Fondit.

### 1.3.2 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative ;
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumenteve të mësipërm, shoqëria administruuese angazhohet se do të respektojë kufizimet e

investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për menaxhimin e rrezikut.

### 1.3.3 OBJEKTIVI I INVESTIMIT DHE STRUKTURA E PLANIFIKUAR E PORTOFOLIT

#### 1.3.3.1 *Objektivi i investimit*

Objektivi i Fondit është që ti japë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe të likuiditetit të nevojshëm.

#### 1.3.3.2 *Struktura e planifikuar e portofolit*

Shoqëria administruese synon të krijojë një portofol të përqëndruar kryesisht në tituj borxhi të emetuar ose garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, qeveri të tjera dhe korporata ndërkombetare. Deri 100% e fondeve mund të investohen në bono dhe obligacione thesari të qeverisë shqiptare, të emetuara në monedhën Euro. Megjithatë, frekuenca e emetimeve në Euro nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përcaktojë shkallën në të cilën Fondi do të investojë në këto lloje instrumentesh.

Me qëllimin për të krijuar një portofol të diversifikuar, shoqëria administruese rezervon të drejtën të investojë në tituj borxhi, të emetuara ose garantuara nga shtete të tjera sovranë, kryesisht në monedhën Euro, të cilat kanë një treg relativisht likuid, dhe vlerë lehtësisht të përcaktueshme, të tregtuara në tregje të rregulluara ose bursat zyrtare të shteteve të BE-së, apo çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja.

Është gjithashtu i mundur investimi në instrumentet e borxhit të emetuara nga pushteteti vendor, ose nga shoqëritë tregtare, të tregtueshëm në tregje të rregulluara ose bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë.

Fondi mund të investojë edhe në kuota të fondeve të investimit apo në aksione të shoqërive të investimit si një tjetër formë diversifikimi.

Fondi mund të investojë gjithashtu në tituj financiarë të transferueshëm ose instrumente të tjera financiare të tregtueshme në bursa ose tregje të tjera të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, vendet e Bashkimit Evropian, ose vende të tjera të aprovuara nga AMF-ja.

#### ***Mjete monetare dhe ekuivalente (cash)***

Shoqëria administruese do të mbajë vazhdimisht një sasi të caktuar cash me qëllim menaxhimin e likuiditetit në përputhje me objektivat e investimit dhe për të përmbushur në kohë çdo detyrim ndaj klientëve të Fondit.

Një pjesë e aseteve të Fondit do të investohet në depozita në Euro në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë, ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj, ose në çertifikata depozitash. Gjithashtu, për administrimin afatshkurtër të likuiditetit mund të përdoren marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes me kushtin që titujt që janë objekt i marrëveshjes të ndodhen brenda investimeve të lejuara, të lejuara, të përmendura në paragrafin 1.3.2.

#### ***Derivatvët***

Instrumentet financiare derivative mund të përdoren si mjet për shmangien e rreziqeve dhe për arritjen e objektivave të investimit të Fondit, por strategjia e investimit nuk do të ndryshojë për shkak të investimit në këto instrumente, dhe ekspozimi ndaj rrezikut nuk mund të tejkalojë nivelet e parashikuara në ligjin nr.10198,

datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", apo në politikat e brendshme të shoqërisë administruese mbi investimet dhe administrimin e rrezikut.

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e synuar dhe maksimumin e lejuar të aseteve të Fondit.

SHPËRNDARJA E ASETEVE TË FONDIT			
Instrumenti	Shpërndarja e synuar e aseteve	Shpërndarja e limituar e aseteve	
Tituj të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe nga autoritetet vendore shqiptare.	40.00%	60.00%	Maksimum
Tituj të emetuar ose garantuar nga shtete dhe autoritete të Bashkimit Europian, nga organizma publike nderkombetare ose nga çdo shtet i lejuar nga AMF-ja	8.00%	20.00%	Maksimum
Depozita bankare, çertifikata depozite, marreveshje të anasjellta të riblerjes, mjete monetare.	5.00%	80.00%	Maksimum
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara ose bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian, apo në shtete të lejuara nga AMF	22.00%	30.00%	Maksimum
Kuota në SIK të tjerë	25.00%	30.00%	Maksimum
Instrumente financiare derivativë	0.00%	0.00%	Maksimum

Shpërndarja e synuar e aseteve mund të ndryshojë në varësi të kushteve të tregut dhe siç parashikohet në Politikën e Investimit, do të rishikohet çdo vit. Shpërndarja e synuar e aseteve tregon se fokusi i investimit do të jetë në tituj borxhi të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Investitori duhet të ketë parasysh që shpërndarja e synuar e aseteve shërben si një orientim dhe nuk mund të ketë siguri se kjo shpërndarje e synuar të arrihet. Në përputhje me politikën dhe objektivin e investimit, fondi do të investojë brenda limiteve të specifikuara më lart për çdo klasë asetesh. Peshë maksimale tregon limitin e sipërm të klasës së aseteve të specifikuar.

Performanca e fondit dhe për rrjedhojë vlera e portofolit të investimeve mund të luhatet në varësi të ecurisë së përgjithshme të tregut dhe faktorëve të tjerë të jashtëm. Shoqëria administruese nuk garanton performancën e fondit, dhe performanca e shkuar nuk shërben si garanci për rezultatet e ardhshme.

Fondi synon që maturiteti mesatar i ponderuar i aseteve të tij (average duration) të mos jetë më tepër se 5 vjet.

#### 1.4 RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND

Investimi në Fondin Raiffeisen Invest Euro i jep investitorit mundësi përfitimi por në të njëjtën kohë shoqërohet me sipërmarrjen e rrezikut nga ky i fundit. Përgjithësisht rreziku nga investimi në tregjet e kapitalit lidhet me mundësinë që kthimi nga investimi të jetë i pakënaqshëm ose negativ.

Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht, në situata tregu të tensionuara apo të jashtëzakonshme investitori mund të humbasë kapital për periudha kohore të shkurtra ose të gjata, por rreziku mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e përshtatshme për administrimin e tij. Për këtë qëllim, shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë, përgjegjëse për kontrollin e të gjitha transaksioneve që kryhen në emër të Fondit. Veprimtaria e kësaj njësie së bashku me metodologjinë e administrimit të rrezikut janë të parashikuara në rregulloret dhe procedurat e brendshme të shoqërisë administruese. Në momentin e vendimarrjes për investime, shoqëria administruese trajton çdo investim të veçantë brenda kuadrit të rrezikut të përgjithshëm që rezulton nga totali i aseteve të Fondit, duke zbatuar parimet e sigurisë,



likuiditetit dhe përfitueshmërisë.

## **FONDI MUND TË MOS JETË NJË INVESTIM I PËRSHTATSHËM PËR TË GJITHË INVESTITORËT.**

Çdo investitor potencial në Fond duhet të gjykojë mbi përshtatshmërinë e investimit në funksion të kushteve dhe nevojave të tij specifike. Në veçanti, çdo investitor potencial duhet:

- të ketë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të saktë të Fondit, të përfitimeve dhe rreziqeve nga investimi në Fond, si edhe të informacionit që përmban ky prospekt dhe çdo dokument tjetër që lidhet me Fondin;
- të ketë njohuri për të vlerësuar sic duhet investimin në Fond, në përputhje me situatën e tij financiare, dhe ndikimin që Fondi do të ketë mbi totalin e portofolit të tij të investimeve;
- të ketë likuiditet të mjaftueshëm dhe burime të tjera financiare për të përballuar të gjitha rreziqet që mund të vijnë nga investimi në Fond;
- të kuptojë plotësisht kushtet e Fondit dhe funksionimin e tregjeve financiare; dhe
- të jetë në gjendje të vlerësojë skenarë të mundshëm që lidhen me faktorë ekonomikë apo të tjerë, të cilët mund të ndikojnë në investimet e tij dhe në shkallën e rrezikut të marrë përsipër.

Fondi është i përshtatshëm për investitorët të cilët kanë një tolerancë mesatare ndaj rrezikut ; megjithatë performanca e Fondit mund të cenohet në veçanti nga rreziqet e mëposhtme:

### **1.4.1 Rreziku i tregut**

Është rreziku i luhatshmërisë së normave të interesit në treg. Bazuar në strategjinë e investimit të parashikuar në këtë prospekt, asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiarë, të cilët janë lirisht të tregtueshëm dhe çmimi i të cilave mund të ndryshojë çdo ditë.

Kur normat e interesit rriten, çmimi i instrumenteve financiarë bie. Kjo sjell ulje të vlerës së portofolit të investimeve e për rrjedhojë rënie të kthimit nga investimi.

### **1.4.2 Rreziku i kurseve të këmbimit**

Në rastin kur asetet e Fondit do të investoheshin në instrumentet financiarë në një monedhë të ndryshme nga euro, Fondi do të ekspozohet për këtë pjesë të aseteve të tij ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit të këtyre monedhave ndaj euros, ku euro është monedha e cila përdoret për të matur kthimin nga investimi të Fondit.

### **1.4.3 Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aseteve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit.

Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që rreziku i kredisë të përjashtohet plotësisht.

### **1.4.4 Rreziku i likuiditetit**

Ky rrezik lidhet me mundësinë që një aset financiar të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut.

Pavarësisht objektivit të Fondit për të krijuar një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë që kanë një treg sekondar aktiv, shitja e një letre me vlerë të caktuar, në momentin e kërkuar, mund të bëhet problematike. Për këtë arsye, rregullat e menaxhimit të likuiditetit do të jenë në përputhje me Rregulloren nr. 21, datë 06.02.2018 "Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve".

#### **1.4.5 Rreziku i shlyerjeve në shuma të mëdha**

Ne varësi të madhësisë së shumës së kërkuar për shlyerje, krahasuar me madhësinë e Fondit, Fondi mund të jetë i detyruar që të ndryshojë kompozimin e portofolit të aseteve të tij në mënyrë domethënëse, në mënyrë që të plotësojë kërkesën për shlyerje.

Kjo mund të ketë një efekt negativ në performancën e Fondit, sepse mund të jetë i detyruar që të shesë një instrument financiar në mënyrë të parakohshme, çka mund të rezultojë në humbje dhe rënie të çmimit të kuotës.

#### **1.4.6 Rreziku rregullator**

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor. Vlera e aseteve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga: ndryshimet e legjislacionit që rregullon fondet e investimeve, nga ana e autoritetit rregullues, nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike kombëtare dhe ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislacionin tatimor etj.

#### **1.4.7 Rreziku i mos-diversifikimit**

Duke qenë se Fondi do të investojë kryesisht në Letra me Vlerë të Qeverisë, ai do të ketë një nivel të kufizuar diversifikimi dhe për rrjedhojë, mund të jetë më i ndjeshëm ndaj ndryshimeve ekonomike, politike, të biznesit ose të tjera që prekin emetues ose investime të ngjashme, krahasuar me një fond të diversifikuar. Kjo mund të rezultojë në një luhajtje më të madhe të vlerës së kuotave të Fondit dhe rreziku i humbjes mund të jetë më i madh.

#### **1.4.8 Rreziku i palës tjetër**

Ky është rreziku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Ai lidhet me moszbatimin e kushteve të një marrëveshjeje të paracaktuar, psh mospagesën tek shitësi ose mosdorëzimin e objektit të marrëveshjes tek blerësi.

#### **1.4.9 Rreziku i performancës**

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

#### **1.4.10 Rreziku i inflacionit**

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku që ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori, pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit, të jenë negative.

Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse ai / ajo mund të ketë patur fitim në terma absolutë.

#### **1.4.11 Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave**

Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerje të kuotave të Fondit. Megjithatë, shoqëria administruese mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara në paragrafin 1.7 të këtij prospekti.

#### **1.4.12 Rreziku i personelit kyc**

Performanca e Fondit, pjesërisht i atribuohet aftësive profesionale të personave përgjegjës në shoqërinë administruese dhe vendimarrjes së duhur nga ana e administratorëve. Por, duke qenë se stafi i shoqërisë

administruese mund të ndryshojë, vendimarrja e re mund të rezultojë më pak e suksesshme.

#### 1.4.13 Rreziku operacional

Ky është rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregëtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emer të Fondit.

#### 1.4.14 Rreziku i vlerësimit të asetëve

Ky lloj rreziku është tipik për tregjet jo likude ose për tregjet që përballen me kriza financiare dhe humbje të besimit. Nëse investitorët njëkohësisht kërkojnë të shlyejnë një numër shumë të madh kuotash në Fond, shoqëria administruese mund të jetë e detyruar të shesë letra me vlerë nga portofoli i Fondit, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre.

**Megjithëse Fondi synon ruajtjen e kapitalit, ekziston mundësia e humbjes nga investimi në Fond.**

### 1.5 SHUMA MINIMALE E INVESTIMIT DHE VLERA FILLESTARE E KUOTËS

Kuotat në Fond janë të emetuara në Euro.

Shuma minimale e investimit në Fond është 250 Euro. Kjo shumë mund të rritet me një vlerë e cila është minimalisht 50 Euro. Nëse balanca e llogarisë mbetet më e vogël se 250 euro, llogaria mund të mbyllet. Në këtë rast, kuotat do të shlyhen me çmimin e aplikueshëm në ditën e mbylljes.

Çdo blerje apo shlyerje kuotash në Fond do të bëhet në Euro. Në rastin kur ligjet dhe rregulloret në zbatim të tyre aktualisht në fuqi, apo kushtet e tregut do të ndryshojnë, shoqëria administruese mund të vendosë që blerja dhe shlyerja e kuotave të kryhet në një monedhë tjetër pas miratimit paraprak nga AMF-ja.

Në momentin e krijimit të Fondit, çmimi i emetimit për kuotë është 100 Euro.

### 1.6 TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT

Në momentin e blerjes së kuotave në Fond, çdo investitor mund të kërkojë lëshimin e një çertifikate e cila vërteton pronësinë mbi kuotat.

Çertifikata lëshohet me kërkesë të investitorit, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e mbërritjes së kërkesës. Ajo përmban : datën e blerjes së kuotave, emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese, numrin e kuotave të blera, emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave, vendin dhe datën e lëshimit të çertifikatës, si dhe nënshkrimin e personit të autorizuar të shoqërisë administruese.

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fond janë:

- E drejta për informacion (raporte vjetore, gjashtë mujore etj) ;
- E drejta për të marrë pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të ;
- E drejta për të shitur kuotat në çdo kohë ;
- E drejta që asetet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese ose të depozitarit, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes. Këto asetet nuk do të përfshihen në asetet e shoqërisë administruese ose të depozitarit gjatë procedurave të likuidimit ose të falimentimit, dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj tyre.

Në lidhje me detyrimet që lindin nga kuotat, mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

## 1.7 MËNYRA DHE KUSHTET E BLERJES APO SHLYERJES SË KUOTAVE

Kuotat do t'i ofrohen investitorit nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes së Bankës Raiffeisen, duke shfrytëzuar fillimisht rrjetin e degëve e më pas mundësitë e përdorimit të shitjeve direkte, shitjet on-line etj. Shlyerja e kuotave do të realizohet gjithashtu nëpërmjet degëve të bankës Raiffeisen.

### 1.7.1 Blerja e kuotave në fond

Blerja e kuotave në Fond kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt. Në rrethana të veçanta, të përcaktuara nga AMF-ja, blerja e kuotave në Fond mund të bëhet edhe në tituj apo asete të tjera, me kushtin që titujt apo asetet e tjera të jenë të tregtuara në tregje të organizuara ose të rregulluara, ku është i mundur të përcaktohet çmimi i tyre i saktë. Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit me nr. ALO3 2151 1031 EUR1 0000 0610 6600, të hapur pranë depozitarit, i cili është Banka e Parë e Investimeve, Shqipëri, sh.a në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Transfertë nga llogaria e investitorit pranë Raiffeisen Bank drejt llogarisë së Fondit (pa komision);
- Transfertë nga llogaria e investitorit pranë çdo banke tjetër të nivelit të dytë (të ndryshme nga Raiffeisen) drejt llogarisë së Fondit, kundrejt tarifave në fuqi.

Blerja e kuotave në fondin Raiffeisen Invest Euro mund të kryhet si më poshtë:

- Nëpërmjet një pagese të menjëhershme në llogarinë e fondit.
  - Nëpërmjet pagesave të rregullta, periodike, në llogarinë e fondit, në formën e planeve të investimit.
- Në rastin e planeve të investimit, shuma minimale e investimit në Fond është 30 Euro.

Çdo investitor që dëshiron të blejë kuota në Fond me pagesë të menjëhershme ose me plan investimi, do të nënshkruajë një kërkesë blerjeje dhe do të bëhet pronar i një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond, i llogaritur në përputhje me ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 « Për sipërmarrjet e investimeve kolektive », rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt. Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 shifra pas presjes dhjetore.

Në rastet kur investitori nuk jep informacionin e duhur, në përputhje me rregulloret e brendshme ose ligjet përkatëse, ose kur ai paraqet një informacion të rremë, Raiffeisen Invest ka të drejtë të refuzojë kërkesën (urdhërin) për blerjen e kuotave, plotësisht ose pjesërisht.

### 1.7.2 Shlyerja e kuotave

Mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shitjen e kuotave të tyre. Investitori duhet të plotësojë një kërkesë për shlyerje të kuotave të Fondit.

Shitja e kuotave në Fond bëhet me një çmim të zbatueshëm në datën e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje në Raiffeisen INVEST sh.a.

Kryerja e pagesës në asete monetare, nga llogaria e Fondit në llogarinë e investitorit do të bëhet brenda 7 ditëve kalendrike nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme për shitje në Raiffeisen INVEST sh.a.

Shënim: Shlyerja e kuotave do të jetë subjekt i komisioneve bankare për transfertat në monedhë të huaj të aplikuar nga banka pritëse pranë së cilës investitori ka llogarinë e tij, sipas kushteve të punës në fuqi.

Në çdo rast e ardhura nga investimi do të jetë subjekt i tatimit sipas dispozitave të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

Në rrethana të veçanta, kur shitja e asetëve të Fondit, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për shlyerjen në vlera të mëdha, mund të kompromentojë pozicionin e investitorëve të përhershëm në Fond, shlyerja e kuotave mund të bëhet duke përdorur asete të Fondit.

Por shlyerja me asete mund të bëhet vetëm duke transferuar atë pjesë të çdo lloji asetesh të Fondit, e cila është në përpjesëtim me numrin e kuotave të investitorëve që kërkojnë shlyerjen dhe vlerën totale të asetëve të Fondit. Nëse kërkesa për shlyerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste, dita e kërkesës së vlefshme për shitjen do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Nëse Raiffeisen Invest sh.a ka arsye të besojë se blerja e kuotave në Fond, në menyrë direkte apo indirekte, është bërë në rrethana të caktuara që konsiderohen si shkelje e ligjeve ose rregulloreve në fuqi (apo të ndonjë interpretimi ligji ose rregulloreje nga autoriteti kompetent), atëhere shoqëria administruese mund të urdherojë shlyerjen e këtyre kuotave.

## 1.8 KËMBIMI I KUOTAVE

Mbajtësit e kuotave të një fondi investimi mund t'i këmbajnë ato me kuota të një fondi tjetër investimi, në të njëjtën monedhë, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, duke respektuar vlerat e shumës minimale të investimit dhe të shumës minimale të mbetur në fond.

Çdo investitor që dëshiron të këmbjë kuota në Fond, do të nënshkruajë një kërkesë për këmbim kuotash.

Për këmbimin e kuotave, numri i Kuotave të Reja të blera do të përcaktohet duke iu referuar çmimeve përkatëse të Kuotave të Reja dhe Kuotave fillestare në momentin e vlerësimit.

Asnjë këmbim nuk do të kryhet gjatë periudhës kur e drejta e investitorëve për të kërkuar shlyerje të kuotave është pezulluar. Këmbimi i kuotave midis dy fondeve të investimit do të kryhet vetëm në një ditë pune kur të dy fondet kanë mundur të nxjerrin çmimet përkatëse të kuotave.

Efekti fiskal i këmbimit të kuotave është i njëjtë si në rastin e shitjes së tyre nga investitori (shlyerjes nga fondi).

## 1.9 PEZULLIMI I SHLYERJES SË KUOTAVE TË FONDIT

Shitja dhe shlyerja e kuotave në Fond, mund të pezullohet në rastet kur:

- Shoqëria Administruese dhe Depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme ka arsye të forta e të justifikuara, për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, në mbrojtje të interesit të mbajtësve ekzistues dhe potencial të kuotave. Shoqëria Administruese, njofton menjëherë AMF-në lidhur me vendimin për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave. AMF-ja, pas marrjes së njoftimit, mund të urdhërojë anulimin e këtij vendimi, nëse gjykon se është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në fond. Shoqëria Administruese publikon, në faqen zyrtare të internetit, në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe me çdo mjet të qëndrueshëm komunikimi, arsyet e pezullimit si dhe detaje të mjaftueshme për mbajtësit e kuotave në mënyrë që të kenë të gjithë informacionin e duhur në lidhje me pezullimin.
- AMF vlerëson se ekzistojnë shkaqe të forta dhe të justifikuara, si dhe nëse kjo është në mbrojtje të interesave të mbajtësve ekzistues ose potencial të kuotave, duke urdhëruar Shoqërinë Administruese dhe Depozitarin të pezullojë përkohësisht shitjen dhe shlyerjen e tyre. AMF publikon në faqen zyrtare të saj, arsyet dhe kohëzgjatjen e pezullimit, në rastet kur kjo e fundit dihet.

Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave duhet të mbarojë menjëherë sapo arsyet për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes nuk ekzistojnë më, dhe jo më vonë se 28 ditë nga fillimi i pezullimit, përveçse nëse AMF-ja jep miratimin me shkrim për zgjatjen e kufirit të dhënë kohor. Rifillimi i veprimtarisë tregtare të Fondit publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese, në një gazetë të përditshme me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi në përputhje me Rregulloren e AMF nr. 154, date 29.09.2016 "Për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve"

### 1.10 ADMINISTRIMI I PJESËS SË FITIMIT PËR MBAJTËSIT E KUOTAVE

Kuotat e Fondit janë kuota akumulimi, që do të thotë kuota për të cilat të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave. Fitimi nga investimi në fond reflektohet në rritjen e cmimit të kuotes. Investitori mund ta tërheqë fitimin nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesëshme të kuotave, në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtë prospekt.

### 1.11 METODA DHE FREKUENCA E VLERËSIMIT TË ASETEVE TË FONDIT DHE ÇMIMIT PËR KUOTË

Shoqëria administruese llogarit vlerën totale të aseteve të Fondit, përcakton detyrimet e tij dhe llogarit vlerën neto të aseteve të Fondit si edhe vlerën neto të aseteve për kuotë. Këto llogaritje bëhen në bazë ditore. Depozitari kontrollon dhe konfirmon llogaritjen e këtyre vlerave dhe është përgjegjës për saktësinë e tyre. Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloren "Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion" e dale në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Mbeshtetur në sa më sipër, si dhe në metodologjinë « Për llogaritjen e vlerës neto të aseteve të Fondit Raiffeisen Invest Euro » të përcaktuar nga shoqëria administruese dhe depozitari, dhe të miratuar nga AMF, portofoli i titujve për tregtim do të rivlerësohet çdo ditë pune duke zbatuar çmimin e tregut të marrë nga platformat Reuters / Bloomberg për çdo titull i cili tregtohet rregullisht në tregjet ndërkombëtare. Në kushtet e një tregu jo-aktiv të letrave me vlerë, rivlerësimi bëhet duke u mbështetur në yield-in deri në maturim i cili llogaritet me metoden e interpolimit linear sipas yield-eve me të fundit të ankanëve të bonove të thesarit apo obligacioneve dhe ditëve të mbetura deri në maturim të letres me vlerë. Yield-it deri në maturim i shtohet një spread i cili përcaktohet nga shoqëria administruese dhe depozitari.

Vlera e kuotës së Fondit në ditën e vlerësimit përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të Fondit në Euro, me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë. Ky numër përputhet me numrin e kuotave në ditën paraardhëse të vlerësimit duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit dhe duke i shtuar numrin e kuotave që Fondi ka emetuar, në ditën e vlerësimit.

Dita e vlerësimit të aseteve të Fondit (t-1) do të jetë një ditë para ditës (t) gjatë së cilës është llogaritur vlera neto e aseteve për kuotë. Depozitari ka detyrimin që të informojë Autoritetin në lidhje me përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve të Fondit dhe çmimit për kuotë në çdo ditë të vlerësimit (t), dhe jo më vonë se ora 12:00 e mesditës së të njëjtës ditë.

## 1.12 INFORMIMI I INVESTITORËVE

Shoqëria administruese është e detyruar t'i paraqesë rregullisht AMF-së raportime për veprimtarinë e saj të brendshme, si dhe për administrimin Fondit duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në Ligj. Raporti vjetor dhe çdo informacion shtesë do të vihen në dispozicion të investitoreve pranë zyrave qendrore të shoqërisë administruese tek blv. Bajram Curri, ETC, Tiranë, pas një kërkesë me shkrim, ose nëpërmjet postës elektronike.

Prospekti i Fondit dhe Rregullat e Fondit do të jenë të disponueshme në çdo degë të Raiffeisen Bank. Çdo ndryshim thelbësor i prospektit, sipas legjislacionit në fuqi, i njoftohet të gjithë investitorëve dhe publikohet në një gazetë të përditshme për një periudhë dymujore gjatë së cilës mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të kërkojnë nga Fondi një shlyerje të kuotave të tyre.

Nderkohë, të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku me çmimin e kuotës do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese.

Ne menyre që të sigurohet informacioni i nevojshëm dhe në kohe, investitori duhet të njoftojë shoqërinë administruese për çdo ndryshim në të dhënat e tij të kontaktit si: adresë, nr. tel etj

## 1.13 MBYLLJA E FONDIT

### 1.13.1 Rrethanat e mbylljes

Shoqëria administruese mund të iniciojë mbylljen e Fondit, kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 « Për sipërmarrjet investimeve kolektive » dhe në mënyrë të veçantë kur:

- ajo mbyll vullnetarisht aktivitetin e saj;
- i nënshtrohet procedurave të falimentit dhe likuidimit si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve;
- AMF-ja i ka hequr përkohësisht ose në mënyrë të përhershme licencën.

### 1.13.2 Kush e kryen procesin e mbylljes?

Mbyllja e Fondit të investimit realizohet nga shoqëria administruese që administron Fondin.

Në rastet kur kjo shoqëri i është nënshtuar procedurave të falimentimit ose kur AMF-ja ka pezulluar përkohësisht ose ka hequr në mënyrë të përhershme licencën e saj, atëherë mbyllja realizohet nga depozitari i Fondit.

Nëse depozitari është duke ju nënshtuar procedurave të falimentimit ose kur licenca e tij si depozitar apo si bankë është pezulluar përkohësisht apo është hequr në mënyrë të përhershme, mbyllja e Fondit do të realizohet nga një likuidues fondi, i caktuar nga AMF-ja.

### 1.13.3 Likuiduesi, procedurat dhe afati kohor për mbylljen e fondit

Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit, likuiduesi është i detyruar të informojë AMF-në dhe të gjithë investitorët e Fondit për mbylljen e Fondit.

Pas marrjes së vendimit për mbyllje, çdo shitje e mëtejshme ose shlyerje e kuotave në Fondin e investimit është e ndaluar, përveçse në rastet e kërkesave të marra pas përcaktimit më të fundit të çmimit dhe para marrjes së vendimit për mbyllje.

Nga data e marrjes së vendimit për mbyllje, nuk ngarkohet asnjë tarifë mbi Fondin.

Likuiduesi është i detyruar t'i paraqesë AMF-së raportet për ecurinë dhe raporte përfundimtare të mbylljes, si dhe është përgjegjës për përgatitjen e raporteve të kërkuara.

Gjatë procedurës së mbylljes, veprimtaria e biznesit në vijim do të ndërpritet. Transaksionet me

asetet e Fondit do të lejohen vetëm për qëllimet e mbylljes së Fondit. Në këtë mënyrë, shiten të gjitha asetet e Fondit, si dhe paguhen detyrimet e tij, të kërkueshme deri në datën e marrjes së vendimit për mbyllje. Pjesa e mbetur e vlerës neto të aseteve të Fondit u shpërndahet mbajtësve të kuotave në përpjesëtim me pjesën e tyre në Fond.

Afati kohor për të realizuar mbylljen e një Fondi investimi do të jetë deri në 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së vendimit për mbylljen e Fondit. Por në rastin kur likuiduesi vendos që është në interesin e kreditorëve dhe mbajtësve të kuotave për të shtyrë këtë afat, Autoriteti mund të miratojë shtyrjen e afatit kohor për realizimin e procedurave të mbylljes edhe për maksimumi 6 muaj të tjerë.

#### 1.14 TARIFAT

Kostoja e administrimit të Fondit është një element i rëndësishëm që ndikon në përzgjedhjen e Fondit nga investitorët, pasi kjo kosto paguhet prej tyre. Megjithatë diferencat mund të jenë të vogla dhe në dukje jo domethënëse, ato mund të kenë një impakt të rëndësishëm në kthimin nga investimi të Fondit.

Tarifat që do t'u ngarkohen mbajtësve të kuotave në Fondin Raiffeisen Invest Euro do të kufizohen vetëm në tarifën e administrimit, e cila do të jetë 1.50% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.

Tarifa e administrimit llogaritet ditë për ditë, sipas formulës së mëposhtme:

$$1.50\% / 365$$

Shoqëria administruese nuk do të aplikojë asnjë tarifë hyrjeje apo largimi nga Fondi.

Fondi nuk do t'i ngarkojë mbajtësit e kuotave me një sërë tarifash si më poshtë:

- a. tarifat dhe kostot, që i paguhen depozitarit;
- b. kostot, komisionet ose shpërblimet për shitblerjen e aseteve;
- c. kostot e mbajtjes së regjistrimit të kuotave, si dhe kostot e shpërndarjes së fitimeve;
- d. kostot e auditimit vjetor;
- e. kostot e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifave postare për raportet gjashtëmujore dhe vjetore për mbajtësit e kuotave;
- f. të gjitha tarifat dhe shpërblimet e parashikuara, që i paguhen AMF-së, për dhënien e licencës për Fondin;
- g. taksat, që paguhen nga Fondi për asetet ose fitimin e tij;
- h. kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt dhe komunikimet e tjera me investitorin.

Tarifat për shpërblim, për reklamimin apo promocionin e kuotave të Fondit dhe të shpërblimeve të përfaqësuesve të Fondit për shitjet merren përsipër nga shoqëria administruese.

Shoqëria administruese mund të ndryshojë tarifat e Fondit në përputhje me ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij. Çdo ndryshim tarifash do të reflektohet në ndryshime në prospektin e Fondit i cili miratohet paraprakisht nga AMF-ja dhe i njoftohet mbajtësve të kuotave në përputhje me paragrafin 1.11 të këtij prospekti.

#### 1.15 SHPENZIME TË TJERA

Të gjithë investitorët në Fond kanë të drejtë të marrin falas vertetime transaksionesh, pasqyra llogarie, raporte vjetore dhe një kopje (fizike) të Prospektit të përditësuar. Shumica e raporteve në lidhje me Fondin dhe llogarinë e investitorit mund të merren falas duke aksesuar llogarinë personale online. Megjithatë, kërkesat jo të zakonshme si p.sh printimi dhe dërgimi me postë i certifikatave (përveç rasteve kur investitori blen kuota të reja) për balancen e kuotave, vertetimet mbi gjendjen e llogarisë dhe vertetime të tjera të ngjashme, duhen dërguar në formë të shkruar nga ana e investitorit, dhe do të lëshohen kundrejt komisionit në fuqi.



## 1.16 TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE MBAJTËSIT TË KUOTAVE

Fondi, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha asetëve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor.

Taksimi i Fondit bazohet në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Të ardhurat që rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në Fond, do të taten sipas Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## 1.17 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Fondit do të jetë viti kalendarik (Janar - Dhjetor).

## 1.18 AUDITUESI

Audituesi i jashtëm i Fondit është KPMG Albania Shpk, me seli në adresën: Blvd "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13 Tiranë, Shqipëri.

Tel: +355 (4) 2274 524

Mail: [al-office@kpmg.com](mailto:al-office@kpmg.com)

Web: [kpmg.com/al](http://kpmg.com/al)

Audituesi i jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbiqyrtjes Financiare.

## 2 INFORMACION MBI DEPOZITARIN

Shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me Bankën e Parë të Investimeve, Albania sh.a me seli në adresën: Bul. "Dëshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë.

Depozitari është liçensuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr. 13 datë 10.03.2010 si dhe është liçensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e pensionit me Vendimin nr. 80, datë 30.08.2010 dhe për sipërmarrjet e investimeve kolektive me Vendimin nr. 1, datë 13.12.2011.

Veprimtaria e mbajtjes së aseteve dhe veprimtari të tjera, të zhvilluara nga depozitari, për shoqërinë administruese, për sa i përket strukturës organizative, veçohen nga veprimtaria e shoqërisë administruese. Asetet e Fondit, përfshirë llogaritë bankare dhe asete të tjera, ruhen dhe mbahen nga depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren as drejtpërdrejt, as në mënyrë të tërthortë për kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose për të marrë ndonjë përfitim për vete a punonjësit e tij, apo për qëllime të tjera, përveç përfitimit të mbajtësve të kuotave.

Asetet e Fondit që mbahen nga depozitari, kanë të drejtën e veçimit, si dhe nuk përfshihen në asetet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, të nisura sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj depozitarit.

Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të Fondit.

Përveç ruajtjes së aseteve të Fondit, depozitari kryen edhe veprimtari të mëposhtme:

- garanton që shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave të realizuara për llogari të fondit të investimit të shoqërisë administruese, janë kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat e Fondit;
- riblen, shlyen kuotat dhe bën pagesa në favor të mbajtësve të kuotave në Fond nga asetet e Fondit;
- garanton që llogaritja e vlerës neto të kuotave në Fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, prospektin dhe rregullat e Fondit;
- zbaton urdhrat e shoqërisë administruese për transaksionet që përfshijnë titujt dhe asetet e tjera që përbëjnë portofolin, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me ligjin, me rregulloret e AMF-së, prospektin dhe/ose rregullat e Fondit dhe bën të mundur realizimin dhe kryerjen e tyre brenda kufijve kohorë të miratuar nga palët ose ligji;
- i raporton shoqërisë administruese për veprimet e Fondit, të cilat i ruan në formë të shkruar ose elektronike;
- arkëton të ardhurat dhe përfitimet e tjera përkatëse në dobi të Fondit dhe që u bashkëngjiten aseteve të tij;
- siguron se fitimi i Fondit përdoret në përputhje me ligjin, me prospektin dhe/ose rregullat e fondit dhe se të gjitha kostot e paguara nga Fondi janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë prospekt dhe/ose rregullat e Fondit;
- i raporton AMF-së për çdo shkelje të ligjit dhe të kontratës nga shoqëria administruese, në rast se kjo shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje.

## 3 INFORMACION MBI SHOQËRINË ADMINISTRUESE

### 3.1 FORMA LIGJORE

Raiffeisen INVEST sh.a – Shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit dhe SIK është një shoqëri aksionare, me seli në Bulevardin “Bajram Curri”, ETC, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i shoqërisë administruese është Raiffeisen Bank sh.a, e cila zotëron 100% të aksioneve.

Shoqëria administruese u krijua në vitin 2005 me një afat të pacaktuar.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 90.000.000 (nëntëdhjetëmilion) lekë.

Raiffeisen INVEST sh.a mbikqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe Ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Raiffeisen INVEST sh.a ka si objekt të aktivitetit të saj:

1. veprimtarinë e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit vullnetar si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, bazuar në licensën nr.1, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, datë 18.10.2010.
2. veprimtarinë e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, mbështetur në licensën me nr.1, datë 13.12.2011, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj vepron me ndershmëri dhe paanësi, me aftësinë dhe kujdesin e duhur, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi, rregullat profesionale dhe praktikat më të mira.

### 3.2 FONDET NËN ADMINISTRIM

Raiffeisen INVEST sh.a administron fondet e mëposhtme :

1. Fondin e investimit Raiffeisen Prestigj (Kodi FI-B1, datë 13.12.2011)
2. Fondin e investimit Raiffeisen Invest Euro (kodi FI-B2, datë 26.09.2012)
3. Fondin e investimit Raiffeisen Vizion (Kodi FI-B4, datë 30.07.2018)
4. Fondin e pensionit Vullnetar Raiffeisen (Nr. Ref. FP 1, datë 18.10.2010)

### 3.3 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët.

#### 3.3.1 Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarit të vetëm të shoqërisë - Raiffeisen Bank sh.a.

#### 3.3.2 Këshilli i administrimit

Këshilli i Administrimit është organi qendror i shoqërisë administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ai kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, prospektet e fondeve nën administrim etj.

Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë si më poshtë:

**Znj. Donalda Gjorga: Kryetare e Këshillit të Administrimit**

Znj. Donalda Gjorga është aktualisht Drejtore e Departamentit të Thesarit në Raiffeisen Bank. Znj. Gjorga ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (MBA) në fushën e Administrimit të Biznesit pranë Fakultetit Ekonomik Tiranë. Donalda ka një eksperiencë 13 vjecare në stitemin bankar, nga të cilat 10 vjet në fushën e investimeve në tregjet financiare pranë Departamentit të Thesarit në Raiffeisen Bank. Znj. Gjorga ka përfunduar me rezultate maksimale testet finale të mbrojtjes së certifikatave: ACI Dealing dhe ACI Diploma të ofruar nga Financial Market Association, që është shoqata më e madhe ndërkombëtare e traders ne tregjet financiare.

**Z. Peter Zilinek: Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit**

Z. Peter Zilinek ka një ekseperiencë të gjerë në industrinë e menaxhimit të asetëve. Aktualisht ai mban pozicionin e Drejtuesit të Grupit në Departamentin e EQL në Raiffeisen Capital Management, Vienë, Austri. Si pjesë e Qendrës së Kompetencës për Menaxhimin e Aseteve në Raiffeisen Bank International (RBI), ai përfaqëson RBI në këshillat mbikëqyrëse të shoqërive që menaxhojnë fondet e investimeve dhe pensione në shumë vende të Europës Qëndrore dhe Lindore.

Z. Zilinek ka diplomë masteri respektivisht në menaxhim financiar dhe juridik si dhe është mbajtës i titullit CFA.

**Znj. Alda SHEHU: Anëtare e Këshillit të Administrimit**

Znj. Shehu është aktualisht Drejtore e Divizionit të Financës në Raiffeisen Bank, Shqipëri. Znj. Shehu ka disa vite eksperiencë bankare dhe audituese. Ajo ka punuar në pozicione të rëndësishme si: CFO në Raiffeisen Bank, Shqipëri, Supervizore Auditit në Deloitte & Touche, Shqipëri, Kosovë etj. Ajo është diplomuar në Financë dhe Kontabilitet në Universitetin e Tiranës. Nga viti 2003 është anëtare e Shoqatës të Kontabilistëve të Çertifikuar (ACCA) dhe nga viti 2005 anëtare e Shoqatës së Thesarmbajtësve të Korporatave (AMCT).

**Znj. Vilma BAÇE: Anëtare e Këshillit të Administrimit**

Znj. Vilma Baçe ka një eksperiencë të gjerë bankare. Ajo ka mbi 10 vjet përvojë progresive në Raiffeisen Bank sh.a. Gjatë periudhës Tetor 2010 – 1 Maj 2016 ajo ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Marketingut & Marrëdhënieve me Publikun në RBAL. Nga 1 Maji 2016, ajo është emëruar në pozicionin e Drejtores së Shitjeve dhe Rrjetit Shpërndares në Raiffeisen Bank sh.a.

Znj. Baçe është diplomuar në Fakultetin Ekonomik në vitin 1998, si dhe ka kryer studime pasuniversitare pranë Universitetit të Misurit në vitin 2004. Për disa vite, Znj. Vilma Baçe është angazhuar si lektore pranë Fakultetit të Gazetarisë, në Universitetin e Tiranës.

**Z. Joan Canaj: Anëtar i Këshillit të Administrimit**

Z. Joan Canaj është aktualisht Drejtor i Divizionit të Riskut të Integruar. Ai ka një eksperiencë të gjatë prej rreth 13 vitesh në Raiffeisen Bank sh.a. Gjatë periudhës Korrik 2008 – Prill 2017 ai ka mbajtur pozicionin Drejtorit të Departamentit të ALCO, Studimeve dhe Analizës. Më parë ai ka mbajtur edhe pozicione të tjera të rëndësishme në bankë si: Drejtor i Departamentit të Strategjisë, Drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Klientëve, etj.

Z. Canaj është diplomuar për Ekonomi Biznesi në Universitetin Aristoteleio të Selanikut, në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Ekonomike në vitin 2001, si dhe është duke kryer studimet EMBA në Selanik.

**Znj. Edlira Konini - Anëtare e Këshillit të Administrimit**

Znj. Edlira Konini ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (grada Master) në Paris, Francë, në degën e Administrimit Biznesit. Ajo ka një eksperiencë 10-vjecare në fushën e investimeve dhe tregjeve financiare.

Edlira ju bashkua Raiffeisen INVEST në vitin 2009, pas një përvoje disa vjecare pranë departamentit të Thesarit dhe Bankingut të Investimeve të Raiffeisen Bank, Shqipëri duke mbajtur pozicionin e drejtores së menaxhimit të portofolit. Ka marrë me rezultate të shkëlqyera certifikatën ACI Dealing, të ofruar nga Financial Market Association, që është shoqata më e madhe ndërkombëtare e traders në tregjet financiare.

**Znj. Alketa Emini: Anëtare e Këshillit të Administrimit**

Znj. Alketa Emini ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (grada Master) në degën e Administrim Biznesit. Ajo ka një eksperiencë 17-vjecare në sistemin bankar në Shqipëri.

Alketa iu bashkua Raiffeisen INVEST në vitin 2017, pas një përvojë trembëdhjetë vjecare pranë departamentit të Menaxhimit të Riskut të Kredive të Raiffeisen Bank Shqiperi ku ka mbajtur pozicionin e drejtores së menaxhimit të Riskut të Kredive Korporate dhe Biznes I Mesëm. Për një periudhe pesë vjecare ka mbajtur pozicionin e Anëtares së Këshillit Mbikëqyres së Raiffeisen Leasing në Shqipëri.

**3.3.3 ADMINISTRATORËT**

Shoqëria administruese drejtohet nga dy administratorë të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të Këshillit të Administrimit. Ata organizojnë dhe menaxhojnë veprimtarinë e shoqërisë administruese, përgatisin dhe propozojnë për miratim në Këshillin e Administrimit rregulloret e përgjithshme të shoqërisë administruese në përputhje me legjislacionin në fuqi, vendosin mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve si dhe kryejnë një sërë detyrash të tjera të përcaktuara në Ligj dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë.

Administratorët e Raiffeisen INVEST sh.a janë :

1. Znj. Edlira KONINI – Administratore e Përgjithshme
2. Znj. Alketa EMINI- zv. Administratore e Përgjithshme

## 4 INFORMACION PLOTËSUES

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikën me të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë me Raiffeisen Invest sh.a ose me ndonjë nga degët e Raiffeisen Bank sh.a në Shqipëri se ky është versioni më i fundit dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

**4.1 ETIKA DHE KONFLIKTI I INTERESIT**

Punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aseteve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal i cili mund të jetë në konflikt me menaxhimin e investimeve në menyrën e duhur, apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

**4.2 KUJDESI**

Raiffeisen Invest sh.a do ta menaxhojë Fondin Raiffeisen Invest Euro në bazë të "Rregullit të Personit të Kujdesshem", sipas të cilit çdo investim duhet të bëhet me gjykim dhe maturi, në të njëjtat rrethana kur një person i kujdesshem, do të ushtronte me zgjuarsiri dhe pjekuri administrimin e pasurive të veta, jo për spekulim, por për investim, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondi do të menaxhohet me profesionalizëm, të denjë për besimin e publikut.

#### 4.3 STATUSI "FATCA"

Bazuar në angazhimet e Grupit Raiffeisen, për të qene në përputhje me legjislacionin fiskal të SHBA, në vecanti me FATCA ("Foreign Account Tax Compliance Act"), fondi do të regjistrohet në Agjencinë Amerikane të të Ardhurave (IRS: US Internal Revenue Service). Shoqëria administruuese do t'i njoftojë investitorët, lidhur me numrin unik (GIIN) për qëllime të FATCA, bazuar në kërkesën e tyre.

#### 4.4 ANKESAT

Nëse keni një ankesë, ju lutem dërgojeni me shkrim në adresën e shoqërisë administruuese, tek Bulevardi Bajram Curri, ETC, Tiranë. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe do t'iu jepet një përgjigje brenda 2 javëve nga data e mbërritjes së tyre.

Prospekti origjinal u miratua nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruuese më datë 22 Gusht 2012 si dhe nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr.135, datë 26 Shtator 2012.

Ndryshime në prospekt:

1. 29 Gusht 2014 miratuar me Vendimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr.115
- 2 . 30 Korrik 2018 miratuar me Vendimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr.146



